


Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.12.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-3970/14, për, ish zyrtarin e lartë z.Ardian Bytyqi, Këshilltar politik ne Ministrin e Diasporës, për shkak se është shmangur gjendja e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-3970/14, qe për trajtim ka pasur zyrtarin z. Ardian Bytyqi, Këshilltar politik në Ministrinë e Diasporës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari z. Ardian Bytyqi, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, këshilltar politik në Ministrinë e Diasporës, është i angazhuar në veprimtari private si pronar dhe person i autorizuar, në një biznes privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin të funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 17.11.2014, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Ardian Bytyqi është përgjigjur duke na njoftuar nëpërmes telefonit se nuk gjendet në Kosovë dhe sapo të kthehet do të vijë në AKK-ë për tu informuar lidhur me shkresën e marrë, ndërkohë z.Bytyqi ka ardhur në AKK-ë me datën 12.12.2014 ku është njoftuar nga

zyrtarët e AKK-së, për faktet që disponon Agjencia lidhur me dyshimin për konflikt të mundshëm të interesit.

z. Bytyqi, gjatë takimit është pajtuar me gjendjen, por na ka njoftuar se biznesi në fjalë nuk zhvillon aktivitet dhe ka mbetur vetëm si biznes i regjistruar në ARBK dhe na ka njoftuar se i ka mbaruar mandati si zyrtar i lartë.

Me datën 19.12.2014, kemi marr njoftimin zyrtar nga Ministria e Diasporës së z. Ardian Bytyqi ka përfunduar mandatin si Këshilltar politik në Ministrinë e Diasporës.

Vlerësojmë se pasi ka përfunduar mandatin si zyrtar i lartë, dhe pas rrethanave të krijuara konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit për zyrtarin Ardian Bytyqi, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

